Kosova & Rajoni

Kosovë/ Një viktimë dhe 17 të plagosur pas sherrit me armë zjarri në disko, i përfshirë një anëtar i FSK dhe një person i kërkuar nga FBI

Përplasja mes dy grupeve rivale në një lokal në Prishtinë shkaktoi një viktimë e 17 të plagosur. Mes personave që u përfshinë në konflikt është edhe Dukagjin Nikolla, një person i kërkuar nga FBI për trafikim të narkotikëve si dhe një pjestëtar i FSK. ***14 gra të plagosura.***

- Të mbuluar nga gjaku dhe të tronditur, pamjet e reja nga sherri në Prishtinë
- EMRI+FOTO/ Ja kush është 39-vjeçari që humbi jetën
- Sveçla njofton për krijimin e një task-force! Një person humbi jetë nga dora e kriminelëve të lënë të lirë

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

Redaksia
5 Gusht, 07:56 | **Përditesimi: 5 Gusht, 15:50**

Share

KOSOVË- Një person mbeti i vdekur dhe 17 të tjerë janë plagosur si pagojë e një përleshje në një lokal, në qendër të Prishtinës pak para mesnatës. Gjatë konfliktit janë përdorur edhe armë, duke sjellë kështu plagosjen e një 39 vjeçari. Kastriot Ramadani, i plagosur rëndë ndërroi jetë në spitalin universitar të Prishtinës për shkak të plagëve të marra. Gjatë sulmit pas një konflikti në lokalin "Bon Vivant" u lënduan nga thyerja e xhamave edhe 17 persona.

Policia bën të ditur se të plagosurit Hysi Geci, Gëzim Zakuti dhe Andi Pajaziti po marrin trajtim mjekësor, ndërsa prokuroria ka lëshuar urdhër ndalimin për përfshirjen e tyre në ngjarjen e rëndë. Gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes grupi hetimor ka sekuestruar edhe 4 gëzhoja. Një prej personave të përfshirë në ngjarje është pjesëtar i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Hysi Geci.

LEXO EDHE:
Konflikti në Hamallaj, familja Kaçi pajiset me urdhër mbrojtjeje nga Gjykata e Durrësit për gardistin Martin Nikolli

Medat kosovare bëjnë të ditur se gjithçka nisi pas një ftese për t'u bashkuar në një tavolinë mes dy grupeve që ndodheshin në lokalin 'bon vivant' në Prishtinë. Hysi Geci, pjesëtar i FSK'së, ndodhej nën shoqërinë e Dukagjin Nikollajt i njohur me nofkën "Duka" dhe Kastriot Ramadanit që mbeti më vonë i vrarë. Ata kanë ftuar Andi Pajazitin i njohur me nofkën "Italiani" në tavolinën e tyre. Për shkak të një konflikti të mëparshëm ata e sulmuan "Italianin" me një shishe birre . Pas kësaj grupet nxorën armët dhe gjuajtën në drejtim të njëri-tjetrit.

Ndërsa Dukagjin Nikollaj ka mundur të largohet dhe është shpallur në kërkim. Ky i fundit, është i kërkuar edhe nga FBI-ja për trafikim narkotikësh, pasi për 5 vjet ishte i përfshirë në trafikimin e sasive të mëdha të marihuanës, duke e marrë nga furnizues në Kanada e duke e shpërndarë nëpër Neë York. Ndërsa Andi Pajaziti, ka qenë protagonist në një tjetër përlasje të amatosur të ndodhur në 2019 në lokalin 'Duplex', ku u plagosën 4 persona. Pajaziti në atë kohë nga arratia tha se përplasja nisi pasi nuk ishin lejuar të futeshin në lokal.

Lajmi ne perditesim...



Share

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 14:52

Vrasja në Prishtinë, një pjesëtar i FSK-së i përfshirë dje në përleshjen me armë

Forca e Sigurisë së Kosovës, informon se në ngjarjen e ndodhur mbrëmë në Prishtinë ishte i përfshirë edhe një pjesëtarë i FSK-së.

'*Forca e Sigurisë së Kosovës pas verifikimit të të gjitha informatave nga autoritetet kompetente të sigurisë, do të veproj bazuar në ligjet dhe rregulloret në fuqi të FSK-së",* njofton FSK.

S.G/Shqiptarja.com

Share

Ora 14:46

Vrasja në Prishtinë, Ministri Sveçla njofton për krijimin e një task-force! Një person humbi jetë nga dora e kriminelëve të lënë të lirë

Palët e përfshira në konflikt mbrëmjen e 4 gushtit në një disko në qendër të Prishtinës janë persona me rrezikshmëri të lartë shoqëri të cilët i kanë shpëtuar burgut bën të ditur ministri i Brendshëm i Kosovës, Xhelal Svelça

Nga përleshja me armë mbeti i vrarë një 39 vjeçar ndërsa 17 të tjerë u plagosën, mes tyre 14 gra.

> *"Edhe sot humbëm një jetë nga dora e kriminelëve të cilët, për arsye të dështimeve të drejtësisë, kanë qenë të lirë. Në qendër të kryeqytetit, shtetasit tanë janë të rrezikuar*

për shkak të kriminelëve që nuk po ndëshkohen nga drejtësia. Ata duke u ndjerë të plotfuqishëm përballë ligjit nuk hezitojnë që hesapet e tyre kriminale t'i zgjidhin me armë e atë në lokale publike në prezencë dhe duke rrezikuar dhjetra të rinj të tjerë" shkruan Svelça në një postim në facebook

Sipas policisë shkak ishte një mosmarrëveshjeje mes disa burrave.

Svelça shprehet kritik ndaj gjykatave.

> *"Kur lëngon drejtësia, situatat e ngjashme janë të pashmangshme. Drejtësia është punë e policisë, e prokurorëve dhe gjyqtarëve. Drejtësia është një sistem i plotë kur të gjithë institucionet përmbushin funksionin e tyre. Është koha e fundit që efikasiteti i Policisë në këtë segment të rritet, por mbi të gjitha përgjegjshmëria dhe vendosmëria e Prokurorisë dhe guximi i gjykatësve për dënime drakonike për këtë kontigjent kriminal"*

Më tej Ministria e Brendshme thotë se do të inicojë themelimin e një taskforce për hetimin e thellë, jo vetëm të këtij rasti, por edhe të rasteve të tjera të ngjashme

> *"Drejtësia është virtyt që duhet mbrojtur nga e tërë shoqëria, përfshirë aktivistët e shoqërisë civile dhe gazetarët. Ndjenja e të drejtës duhet të jetë shqetësim për të gjithë ne. Shembujt e ndëshkimit të krimit shërbejnë edhe si mbështetje për rolin e policisë sonë"*

S.G/Shqiptarja.com

Share

Ora 14:28

Të mbuluar nga gjaku dhe të tronditur, dalin pamje të reja nga përleshja në Prishtinë

Mediat e Kosovës kanë publikuar pamje të reja nga përleshja me armë në qendër të Prishtinës, mbrëmjen e shkuar.

Në disa video tregohen disa pjesë nga momentet e para pas ngjarjes, ku duket fillimisht një burrë i shtrirë në tokë, i mbuluar nga gjaku dhe dy të tjerë që i japin ndihmën e parë.

Ndërsa, pak pasi ambulanca mbërrin në vendngjarje, nw video hsfaqen disa nga vajzat që ishin në lokalin në qendër të Prishtinës.

Njëra nga 14 gratë që u plagosën, duket në planet e publikuara nga mediat, e fashuar në këmbë dhe e gjakosur kudo.

Ndërsa kaosi dhe tronditja e disa prej të pranishmëve mbizotëron në pamjet e shkurtëra të publikuara.

Ndërkohë, 21 persona kanë mbetur të lënduar pas të shtënave me armë zjarri në një lokal në qendër të Prishtinës, katër prej të cilëve nga arma e zjarrit dhe të tjerët nga copa xhami apo sende të tjera.

M.T/Shqiptarja.com

Share

Ora 12:05

Njëri prej të dyshuarve në përleshjen me armë në Prishtinë, i kërkuar edhe nga FBI-ja

Njëri prej të dyshuarve për përfshirje në vrasjen dhe plagosjen e disa personave në lokalin "Bon Vivant" në Prishtinë të premten, gjendet në arrati.
Mësohet se ai është Dukagjin Nikollaj, i kërkuar edhe nga FBI-ja për trafikim narkotikësh.

Nikollaj njihet ndryshe me nofkën "Duka".

Në fletë-kërkimin e FBI-së thuhet se ai për pesë vjet ishte i përfshirë në trafikimin e sasive të mëdha të marihuanës, duke e marrë nga furnizues në Kanada e duke e shpërndarë nëpër New York, shkruan koha.net.

Një person vdiq nga katër të plagosurit, kurse 17 janë lënduar. Ngjarja raportohet se ndodhi si pasojë e një mosmarrëveshjeje mes të dyshuarve, katër prej të cilëve janë nën vëzhgimin e Policisë e që gjenden në SHSKUK për t'u trajtuar e një tjetër në arrati

S.G/Shqiptarja.com

Share

Ora 11:36

EMRI+FOTO/ Përplasja me armë në Prishtinë, ja kush është 39-vjeçari që humbi jetën



Përleshja me armë zjarri në qendër të Prishtinës, mbrëmjen e shkuar ka rezultuar fatale për Kastriot Ramadani,i cili ndërroi jetë në në spital në orët e para të mëngjesit të sotëm.

Personi që shihni në foto është 39-vjeçari që humbi jetën nga të shtënave me armë në një lokal në Prishtinë.

> *"Po, ka vdekur një prej personave të plagosur mbrëmë, një 39-vjeçar. ishte nën kujdesin intensiv kishte intervenim kirurgjik por për shkak të lëndimeve të mëdha, fatkeqësisht ka vdekur në orët e hershme të mëngjesit të sotëm", tha doktori Shaqir Uka për mediat.*

Ndërkohë, 21 persona kanë mbetur të lënduar pas të shtënave me armë zjarri në një lokal në qendër të Prishtinës, katër prej të cilëve nga arma e zjarrit dhe të tjerët nga copa xhami apo sende të tjera. Po ashtu raportohet se ngjarja ka ndodhur pas një mosmarrëveshje. Mes personave të plagosur, 14 janë gra.

M.T/Shqiptarja.com

Share

Ora 09:01

Kosovë, vdes njëri prej të plagosurve në sherrin masiv në disko në qendër të Prishtinës! 14 prej të plagosurave janë vajza

Një 39-vjeçar ka vdekur në orët e hershme të mëngjesit sot i cili ishte i plagosur nga incidenti i natës së mbrëmshme në rrugën "Rexhep Luci" në Prishtinë.

Mësohet se viktima nuk mundi ti mbijetonte plagëve të rënda dhe humbi jetën në spital, tha doktor Shaqir Uka nga Klinika Intensive

"Ka vdekur njëri prej të lënduarve nga plagët që kishte nga gjuajtja me armë në orët e mbrëmshme në Prishtinë".

"Ai ishte nën kujdesin intensiv kishte intervenik kirurgjik por për shkak të lëndimeve të mëdha, fatkeqësisht ka ndërruar jetë pasi nuk ka arritur t'i përballojë plagët", ka thënë Uka citon Klan Kosova.

Incidenti i mbrëmshëm ka ndodhur për shkak të një zënke në lokal. Sipas policisë, dy persona janë identifikuar si të implikuar në sherrin ku mbetën të lënduar 17 persona, 14 prej tyre janë vajza.

S.G/Shqiptarja.com

Share

S.G/SI.E./Shqiptarja.com

TAG: sherr

Komento

Komente

emigranti: 05/08/2023 15:39

bjerini shqipe!!! kosove-shqipni nje gjuhe, nje komb, nje m... jemi

Përgjigju

ARBER: 05/08/2023 09:13

NgaShengjini ne Prishtine… Vazhdon vllavrasja mes shqiptarve te Kosoves… Shyqyr qe ne keto perplasje nuk ka patur shqiptar nga matan Drinit, se do kushin bere namin "Patriotat" !!! Mullini i serbit vazhdon te bluaj me tre turne… Uje po i çojme boll!

Përgjigju

Sërbi: 05/08/2023 08:06

Nuk ka nevojë. t'ju vrasim ne.Ju lumtë bre vëllezër se ja zbardhët faqen NëNËS.

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH COM

Sondazhi i ditës:
Mungesa e shërbimeve në spitale, a duhet të nisin hetimet?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

EMRAT/ Plagosi me thikë, krushkun dhe djalin e tij 18-vjeçar! Në pranga 43-vjeçari në Divjakë

1 Gusht, 13:49

Sherri në Hamallaj, zbardhet dëshmia e gardistit: Qëllova me arme për të ndalur konfliktin! Kaçi për Report Tv: Punimet e tyre, s'janë projekt nga shteti, më sulmuan

Artur Korriku

Sokol Dema

31 Korrik, 10:48

Sherr në Himarë, u konfliktuan me dy vëllezer dhe i kërcënuan duke qëlluar me pistoletë në ajër! Në pranga 2 persona, nën hetim 2 të tjerë

30 Korrik, 09:58

EMRAT/ Sherr për motive të dobëta mes dy të rinjve në Shijak, plagoset 30-vjeçari! Arrestohet 18-vjeçari

22 Korrik, 14:31

E rëndë në Kosovë, 17-vjeçari masakrohet me thikë nga bashkëmoshatari i tij! I riu vdiq rrugës për në spital

21 Korrik, 11:19

Sherr mes dy personave në Durrës, plagoset me thikë 36-vjeçari! Në pranga autorit 41-vjeçar

20 Korrik, 13:00

EMRAT/Elbasan, qëlluan me armë në ajër pas një konflikti me dy vëllezër! Në kërkim autorët, ndërsa një 40-vjeçar u vu në pranga

17 Korrik, 14:12

EMRI/ 'Pse me parakalove' sherr mes të rinjve në Shkodër! 28-vjeçari merr kallashin dhe i drejtohet shoferit, ngjarja e rëndë parandalohet nga policia

17 Korrik, 13:30

EMRAT/ Babë e bijë shkuan për të shkëputur martesën në shtëpinë e dhëndrit, plas sherri mes dy familjeve në Durrës! 3 në pranga, një në hetim

17 Korrik, 12:15

Goditi me grushte dhe thikë një person, pas një konflikti për motive të dobëta! Në pranga 16-vjeçari në Durrës

17 Korrik, 11:37



VIDEO/ Vrasja në Selanik, momenti kur 50-vjeçari shqiptar qëllohet për vdekje në një pikë karburanti! Kamerat fiksuan gjithë ngjarjen

13 Korrik, 15:09

VIDEO/ Ekzekutohet me tre plumba shqiptari në Selanik! U përlesh me autorët jashtë një karburanti! Autori në kërkim

13 Korrik, 13:52

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje